



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 128 Prot

Tiranë, më 27.07 2009

VENDIM Nr. 10 dt. 20.07.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.07.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

Sipas pikave të rendit të ditës:

I. Të miratojë projektet;

1. **Miratohet** projekti “Kompleks reaktiv tek Fusha e Zezë”(sipas Kontratë Bashkëpunimi midis Mbretit Leka I Zogu dhe z. Alban Xhillari).
2. **Miratohet** projekti “Rikualifikim i lulishtes Millenium”.
3. **Miratohet** projekti “Lokal Valle Verde”.
4. **Miratohet** “Projekt përshtatje kompleksi i banimit multifunksional, i Vasil Merdanit, zona tampon, Berat”.
5. **Miratohet** projekti i rishikuar i “Projekt restaurim i banesës së Dhimitër Ikonomit, lagjia Goricë, Berat”.
6. **Miratohet** Projekt rikonstruksioni banesa Thanas Tapia, Berat
7. **Miratohet me shumicë votash:** “Projekt i rikonstruksionit të banesës Besnik Guri, Elbasan”.
8. **Miratohet** projekti “Restaurim i kullës juglindore në kalanë e Elbasanit”(Të ndiqen procedurat ligjore për marrjen me qera të kullës juglindore nga z. Besnik Guri)
9. **Projekti** “Shtesa e verandës dhe Guzhinës, lokali “Valle Verde”.
Miratohet Mbyllja e verandës.(Shtesa e guzhinës të diskutohet në mbledhjen e rradhës).

II. Do të diskutohen në Mbledhjet e ardhshme kërkesat:

1. Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
2. Kërkesë për ndërtim banese pranë lagjes kala, Elbasan. Fidelino Halo.
3. Kërkesë për leje rikonstrukcioni ish ambientet e Institutit të Arkeologjisë dhe palestrën sportive në zgjatim të saj. (Dokumentacioni i kërkuar është pranë IMK).
4. Projekt përshtatje fasade për banesën me pronar Zenel Sheshalliu, Zona tampon, Berat.
5. Projekt rikonstrukcioni për banesën e Vangjel Felahut, lagja 10 Korriku, Berat.
6. Projekt restaurimi i kompleksit të familjes Nikolin Ujka, Shkodër.
7. Mbulimi tek kinema “Millenium”

III. Do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme pika IV dhe V e rendit të ditës:

Diskutimi i projekteve të cilat presin financim:

1. Projekt idenë e rikonceptimit tërësor të mozaikut të Tiranës.
2. Projekti i restaurimit dhe rihabilitimit të kishës në Derven, Laç.
3. Projekti i restaurimit të Teqes së Sheh Dyrri, Tiranë.
4. Preventivi i punimeve për Teqenë e Frashërit, Gjirokastrë, relacion, preventiv. (Vazhdim)
5. Projekti i konsolidimit të pikturës murale në kishën Shën Mëria, Dhërmi.
6. Restaurimi i banesës së At Gjergj Fishtës, Lezhë.
7. Restaurimi në qytetin “Nikaia”, Klos, Mallakastër.

Diskutimi i kërkesave që duhen parë nga ana ligjore.

1. **Mbetet të diskutohet në një mbledhje tjetër Projekt-studim për rikonstrukcionin e kompleksit të familjes Shkarpa, kala Berat.(Kërkohe konsolidimi i rrugës së dëmtuar si pasojë e gërmimit.)**
2. **“Projekt Zbatim Lulishtja Millenium” pritet të diskutohet në mbledhjet e rradhës pas përfundimit të procedurës juridike.**

Diskutimi i kërkesave për licensë:

1. Kërkesë e znj. Adelina Baballëku, për pajisje me licensë të kat.
Kat. A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, për nënkategoritë:
A/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat A/3, A/4).
A/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të

kategorisë së parë dhe të dytë.

A/4. Projektim dhe zbatim në restaurimin e Qendrave Historike.

2. Kërkesa e Sokrat Kuvarati, për pajisje me licensë të

Kat. B. Restaurim i veprave të artit dhe objekteve muzeale, për nënkategoritë:

B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve.

B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin vepra të arti në dru.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ARDJAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

